



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 136

Tiranë – E Premte, 29 Gusht 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim i përbashkët i MF dhe MZHEËS nr. 17, datë 30.6.2014	Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontroleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013.....	6267
Udhëzim i MTI dhe MPB nr. 4351, datë 15.8.2014	Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave.....	6273



UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 17, datë 30.6.2014

PËR FALJEN E DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË FORMËN E GJOBAVE, TË VËNA NË BAZË TË KONTROLLEVE DHE VERIFIKIMEVE TATIMORE, TË KRYERA PËR PERIUdhËN 1 MARS DERI MË 31 GUSHT 2013

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 39/2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013”, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të neneve 1 dhe 2 të ligjit nr. 39/2014, përfiton nga falja tatimpaguesi sipas kuptimit të nenit 5, pika 1, shkronja “g” e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili është: a) individ, b) person fizik, dhe/apo c) person juridik, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe agjenti i mbajtjes së tatimit në burim.

2. Objekt i faljes janë gjobat që janë evidentuar ose kontabilizuar në regjistrat tatimorë (sistemi informatik ose kontabilitet) nga data 1 mars 2013 deri më datë 31 gusht 2013, nga:

a) Administrata tatimore qendrore, për gjobat e zbatuara nga drejtoritë rajonale tatimore dhe strukturat përkatëse tatimore në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

b) Administrata tatimore vendore në njësitë e qeverisjes vendore (bashki e komuna) për gjobat e zbatuara nga drejtoritë/zyrat përkatëse të taksave vendore.

3. Në zbatim të nenit 3 të ligjit, gjobat që falen janë gjobat që janë vendosur si pjesë e detyrimit tatimor, ku përfshihen si të tilla gjobat e vlerësuara për shkelle të dispozitave të legjislacionit tatimor.

3.1 Falen gjobat e vlerësuara që lidhen me një tatim/kontribut të vlerësuar, të cilat vendosen si pasojë dhe pjesë e tatimit/kontributit;

3.2 Falen gjobat e vlerësuara, të cilat vendosen pavarësisht nëse ka detyrim tatimor (tatim/kontribut) të vlerësuar ose jo;

3.3 Falen, gjithashtu:

a) gjobat për punonjës të padeklaruar apo të deklaruar me vonesë;

b) gjobat për mosinstalim të pajisjes fiskale;

c) gjobat për moslëshim të kuponit tatimor ose moslëshim të biletave.

4. Sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, falen:

a) gjobat e vlerësuara që janë paguar ose kompensuar;

b) gjobat e vlerësuara që nuk janë paguar;

c) gjobat e vlerësuara që janë apeluar apo janë në proces apelimi, pavarësisht nga faza e apelimit në të cilën ndodhen (ankim administrativ apo gjyqësor) dhe pavarësisht nga vendimi i apelimit, nëse ka ndonjë vendim të tillë të dhënë, qoftë edhe i formës së prerë.

5. Sipas objektit të ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, është kusht që gjobat që përfitojnë nga falja të jenë të evidentuara ose të kontabilizuara në regjistrat tatimorë nga data 1 mars 2013 deri më datën 31 gusht 2013.

a) Këto gjoba konsiderohen të evidentuara nga 1 mars 2013 deri më 31 gusht 2013, nëse data e nxjerrjes së njoftim-vlerësimit është nga data 1 mars 2013 deri më datë 31 gusht 2013.

b) Data e kontabilizimit i referohet datës së regjistrimit të gjobave në kontabilitetin e drejtorisë rajonale tatimore përkatëse apo organit të ngjashëm të taksave vendore, jashtë sistemit informatik tatimor përkatës.

c) Në rast të mungesës së një njoftim vlerësimi tatimor për gjobën (nuk është lëshuar njoftim vlerësimi për gjobën apo gjoba nuk është përfshirë si pjesë e ndonjë njoftim vlerësimi të lëshuar), si datë evidentimi konsiderohet data e kontabilizimit të gjobës në regjistrat tatimorë. Kjo datë duhet të jetë brenda periudhës duke filluar nga 1 mars 2013 deri më 31 gusht 2013.

6. Në zbatim të nenit 3 të ligjit, si datë e evidentimit të gjobës konsiderohet data e nxjerrjes së njoftim vlerësimit tatimor (data e protokollit të drejtorisë rajonale tatimore/njësisë së ngjashme që ka përgjegjësinë të lëshojë aktin administrativ tatimor).

6.1 Drejtoritë rajonale tatimore dhe zyrat tatimore të qeverisjes vendore, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, evidentojnë në një listë tatimpaguesit që përfitojnë nga falja sipas këtij ligji.

6.2 Në zbatim të nenit 3 të ligjit, do të përfshihen në listat që do të hartohen për këtë qëllim çdo tatimpagues, të cilit i është lëshuar një njoftim vlerësimi tatimor që mban çdonjëren nga datat në intervalin që prej 1 mars 2013 deri më 31 gusht 2013.



6.3 Për rastet kur nuk është lëshuar njoftim vlerësimi për gjobën nga drejtoritë rajonale tatimore ose zyrat tatimore të qeverisjes vendore, si datë evidentimi në mungesë të njoftim vlerësimit është data e kontabilizimit të gjobës në regjistrat tatimore përkatës.

6.4 Në listën që do të hartohet për këtë qëllim, përveç të dhënave identifikuese të tatimpaguesit, do të përfshihen: masa e gjobës; periudha për të cilën është vendosur gjoba; lloji i gjobës; data e lëshimit të njoftim vlerësimit; data e vlerësimit në sistemin informatik të tatimeve/taksave vendore; data e pagesës, nëse gjoba është paguar; të dhëna të tjera mbi procesin e apelimit nëse ka.

7. Një listë paraprake brenda 15 ditëve të para që nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi publikohet në web-siten e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe web-sitet përkatëse të drejtorive/zyrave të taksave të qeverisjes vendore. Çdo tatimpagues që ka një njoftim vlerësim të lëshuar nga administrata tatimore qendrore dhe vendore që mban datën nga 1 mars 2013 deri më datë 31 gusht 2013 dhe që nuk konstaton emrin e tij në listën e publikuar, i drejtohet me kërkesë me shkrim drejtorisë rajonale tatimore që ka lëshuar njoftim vlerësimin, duke i bashkëngjitur kërkesës një kopje të njoftim vlerësimit dhe çdo dokument tjetër që disponon për gjobën e aplikuar.

8. Në zbatim të nenit 4 të ligjit nuk falet/n, pasi nuk janë objekt i faljes, pavarësisht datës apo periudhës në të cilën janë vlerësuar apo i përkasin:

a) Tatimi/kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

b) Kamatëvonesa pjesë e detyrimit tatimor;

c) Gjobat për pagesë të vonuar / gjobat për dorëzim të vonuar të deklaratës që llogariten dhe vlerësohen automatikisht nga sistemi informatik i tatimeve për deklaratën ose tatimin/kontributin përkatës për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Pas evidentimit të tatimpaguesve përfitues, drejtoritë rajonale tatimore dhe zyrat tatimore të qeverisjes vendore do të kryejnë procedurën si më poshtë vijon:

i) Për çdo tatimpagues përfitues, i cili rezulton në regjistrin tatimor me gjoba që janë objekt i faljes sipas ligjit nr. 39/2014, inspektori i Drejtorisë së Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit që administron dosjen të këtij tatimpaguesi, mban një akt-falje dënimi (gjobë)

me titull “Akt për faljen e gjobës në zbatim të ligjit nr. 39/2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013”, sipas formatit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;

ii) Ky akt shoqërohet me formularin përkatës të faljes së dënimit (gjobës) që përgatitet nga inspektori dhe i nevojshëm për t’u vlerësuar në sistemin informatik. Gjithashtu çdo akti të mbajtur për këtë qëllim i bashkëngjitet një kopje e praktikës sipas së cilës është vendosur gjoba përkatëse së bashku me njoftim vlerësimin tatimor. Në akt shprehen të gjitha detajet që kanë të bëjnë me gjobën që falet dhe që e bëjnë atë të jetë objekt i faljes sipas këtij ligji;

iii) Çdo akt-falje dënimi shoqërohet me një akt administrativ “Njoftim për faljen e gjobës”, sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili përgatitet në 3 kopje, njëra prej të cilave i dërgohet tatimpaguesit që ka përfituar nga falja sipas këtij ligji.

10. Për tatimpaguesit të cilët i kanë paguar gjobat objekt i faljes, në zbatim të nenit 5 të ligjit, do të kryhet procedura e rimbursimit në masën 100% të shumës së gjobës së paguar:

a) Tatimpaguesi paraqet në drejtorinë rajonale tatimore dokumentin që vërteton pagesën e gjobës objekt i faljes, duke e shoqëruar atë me një kërkesë formale për rimbursimin e gjobës së paguar. Kërkesa përmban të dhënat identifikuese të tatimpaguesit, si dhe numrin e tij të llogarisë bankare;

b) Inspektori i vlerësimit, pasi kryen verifikimet e nevojshme që tatimpaguesi është përfitues nga ligji dhe e ka paguar gjobën objekt i faljes, mban një akt-falje dënimi (gjobë) sipas formatit nr. 1, si më sipër, ku të jetë cilësuar se ky dënim falet në zbatim të ligjit për faljen e gjobave. Ky akt shoqërohet gjithashtu me formularin përkatës, të nevojshëm që falja të vlerësohet në sistemin informatik;

c) Për rastet kur gjoba e paguar është falur, pas procesit të vlerësimit të faljes në sistemin informatik, tatimpaguesi për gjobën e falur dhe të paguar njëkohësisht do të rezultojë kreditor. Kështu drejtoria rajonale tatimore rimbursion shumën e gjobës në llogarinë e tatimpaguesit nëpërmjet thesarit sipas pikës 1 të udhëzimit nr. 4/1, datë 23.5.2014 “Për një shtesë në pikën 75.1.1 germa “a” të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por në të njëjtën kohë sistemon edhe situatën e tatimpaguesit në mënyrë që të mos rezultojë me tepriçë kreditore ndaj organit tatimor.



Në këtë rast akti i faljes së gjobës shoqërohet me një akt administrativ “Njoftim për rimbursimin e pagesës së gjobës së falur”, sipas formatit nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili përgatitet në 3 kopje, njëra prej të cilave i dërgohet tatimpaguesit që ka përfituar nga falja sipas këtij ligji.

10.1 Për çdo rast që tatimpaguesi nuk paraqet një kërkesë me shkrim, edhe pse e ka bërë pagesën e gjobës, administrata tatimore pasi verifikon vetë që pagesa e gjobës së falur është kryer, vijon procedurën për evidentimin e faljes dhe rimbursimin e saj sipas pikës 10, germa “b” dhe “c” të këtij udhëzimi.

10.2 Sipas nenit 5 të ligjit, rimbursimi i gjobës së paguar do të kryhet 100 % sipas radhës së datës së pagesës së bërë për gjobën.

10.3 Nëse tatimpaguesi me kërkesën e tij heq dorë nga rimbursimi i shumës së gjobës së paguar duke e destinuar shumën për t’u rimbursuar për pagesë të detyrimeve të tjera tatimore, drejtoria rajonale tatimore vijon me procedurat dhe kryen kompensimin e detyrimeve tatimore me shumën e gjobës së paguar dhe të falur.

10.4 Nëse evidentohen raste kur tatimpaguesi përfitues sipas këtij ligji për faljen e gjobës ka detyrime tatimore të papaguara (tatim/kontribut; gjobë automatike; kamatëvonesë/gjoba të tjera që nuk janë objekt i faljes, edhe pse këto detyrime apo gjoba nuk i përkasin periudhës së faljes, atëherë:

a) Për tatimpaguesit që nuk i kanë paguar gjobat që falen, organi tatimor/zyrat e taksave të qeverisjes vendore vijojnë procedurat e faljes;

b) Për tatimpaguesit që i kanë paguar gjobat që falen, organi tatimor/zyrat e taksave të qeverisjes vendore nuk i rimbursin në llogarinë e tatimpaguesit shumat e gjobave të falura dhe njëkohësisht të paguara, por kompenson detyrimet e tjera që nuk janë në proces apelimi, dhe për shumat e mbetura pas kompensimit vijon procedurat e rimbursimit në llogarinë e tatimpaguesit nëpërmjet thesarit sipas pikës 1 të udhëzimit nr. 4/1, datë 23.5.2014 “Për një shtesë në pikën 75.1.1 germa “a” të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

11. Për të gjitha gjobat që përfitojnë nga falja sipas ligjit nr. 39/2014, nëse kanë filluar, administrata tatimore qendrore dhe vendore ndërpresin procedurat e mbledhjes me forcë për çdo gjobë për shumën që është objekt i faljes sipas këtij ligji.

12. Për të gjithë tatimpaguesit që përfitojnë nga falja sipas ligjit nr. 39/2014 hartohet një listë ku identifikohet emri i subjektit, NUIS (NIPT), shuma e gjobës së falur, lloji i gjobës, shuma e rimbursuar kur gjoba është paguar. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/drejtoritë rajonale tatimore dhe zyrat e taksave të qeverisjes vendore krijojnë në web-site një link ku të evidentohet vazhdimisht lista e azhurnuar e subjekteve që përfitojnë nga falja sipas ligjit.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve/drejtoritë rajonale tatimore/zyrat përkatëse të taksave të njërive të qeverisjes vendore i dërgojnë Ministrisë së Financave listën e subjekteve përfitues dhe vlerën e gjobave përkatëse përpara përfundimit të afatit 5-mujor nga data e hyrjes në fuqi të ligjit. Kjo listë publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

14. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe strukturat e saj në varësi, si dhe drejtoritë/zyrat e taksave të qeverisjes vendore dhe strukturat përkatëse të tyre që, sipas afateve të përcaktuara, të bëjnë pasqyrimet konkrete të gjobave të falura sipas ligjit në regjistrat përkatës.

15. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, afati për përfundimin e këtij procesi nga të gjitha strukturat administrative është data 29 tetor 2014.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
 DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot.

Datë/...../.....

Formati nr.1

AKT PËR FALJEN E GJOBËS NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 39/2014 “PËR FALJEN E DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË FORMËN E GJOBAVE, TË VËNA NË BAZË TË KONTROLLEVE DHE VERIFIKIMEVE TATIMORE, TË KRYERA PËR PERIUdhËN 1 MARS DERI MË 31 GUSHT 2013”

Në zbatim të ligjit nr. 39/2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013”, dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në zbatim të këtij ligji, mbahet sot në datë _____ nga inspektori i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, akti i faljes së dënimit (gjobë) për subjektin “ _____ ” me NIPT _____.

Kjo gjobë është evidentuar në DRT _____ me njoftim vlerësimi tatimor nr. _____ prot, datë _____/ me akt kontabilizim gjobë nr _____ prot, datë _____, sipas së cilit ky subjekt është penalizuar me gjobë/at në vlerën _____ për llojin/et e tatimit _____ për periudhën/at tatimore _____.

Referuar dispozitave të ligjit dhe udhëzimit të sipërpërmendur, kjo gjobë është objekt i faljes dhe si e tillë në zbatim të sa më sipër, falet gjoba në vlerën _____.

Sipas të dhënave që administrohen në DRT, kjo gjobë nuk është paguar/ është paguar/kompensuar në datë _____.

Bashkëlidhur këtij akti janë:

- Formular anulimi _____ fletë;
- Njoftim vlerësimi tatimor nr _____, datë _____ /akt kontabilizim gjobë nr _____, datë _____;
- Njoftim subjektit për faljen e gjobës;
- Dokumenti i pagesës së gjobës.

DREJTORI

Përgatiti: _____, inspektor

Konfirmoi: _____, përgjegjës

Miratoi: _____, drejtor

Shënim. Ky formular do të përdoret si model dhe përmban të dhënat e domosdoshme, të cilat sipas rasteve që paraqiten mund të shtohen dhe të përshtaten nga inspektori që përgatit këtë akt.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr. _____ Prot

Datë/...../.....

Formati nr.2.

NJOFTIM PËR FALJEN E GJOBËS

Për: Subjektin “ _____ ”

Z. _____

NIPT: _____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit nr. 39/2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013”, dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në zbatim të këtij ligji ju njoftojmë se:

Gjoba/at sipas njoftim vlerësimit tatimor nr. _____ prot, datë _____, / akt kontabilizim gjobë nr. _____, datë _____, në vlerën, _____ për llojin e tatimit _____, për periudhën tatimore _____, është falur.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Përgatiti: _____, inspektor

Konfirmoi: _____, përgjegjës

Miratoi: _____, drejtor

Shënim. Ky formular do të përdoret si model dhe përmban të dhënat e domosdoshme, të cilat sipas rasteve që paraqiten mund të shtohen dhe të përshtaten nga inspektori që përgatit këtë njoftim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot

Datë/...../.....

Formati nr.3

NJOFTIM PËR RIMBURSIMIN E PAGESËS SË GJOBËS SË FALUR

Për : Subjektin “ _____ ”

Z. _____

NIPT: _____

Adresa: _____

Me kërkesën tuaj nr _____, datë, protokolluar me tonën nr _____, datë, keni kërkuar rimbursimin/kompensimin e gjobës/ave në vlerën _____ leke, për llojin/et e tatimit _____ për periudhën/at tatimore _____, sipas njoftim vlerësimin tatimor nr. _____ prot, datë _____/ akt kontabilizim gjobë nr. _____ prot, datë _____.

Në zbatim të ligjit nr. 39/2014 “Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave, të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore, të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013”, dhe udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në zbatim të këtij ligji, kjo gjobë është falur:

Sipas dokumentit të paraqitur nga ana juaj dhe të dhënave që disponohen në institucionin tonë, kjo gjobë rezulton të jetë paguar/kompensuar në datë _____.

Përsa më sipër, Ju njoftojmë se sipas kërkesës suaj, gjoba e falur në vlerën _____ lekë, ju është rimbursuar në nr. e llogarisë bankare _____/kompensuar me detyrimin në vlerën _____ lekë, për llojin e tatimit _____, për periudhën tatimore _____.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Përgatiti: _____, inspektor

Konfirmoi: _____, përgjegjës

Miratoi: _____, drejtor

Shënim. Ky formular do të përdoret edhe në rastin kur tatimpaguesi rezulton që ka paguar/ ose i janë kompensuar gjobat e falura, por nuk ka paraqitur kërkesë për rimbursim/kompensim pranë organit tatimor përkatës.

Ky formular do të përdoret si model dhe përmban të dhënat e domosdoshme, të cilat sipas rasteve që paraqiten mund të shtohen dhe të përshtaten nga inspektori që përgatit këtë njoftim.



UDHËZIM

Nr. 4351, datë 15.8.2014

**MBI KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E
MJETEVE TË RËNDA PËR TRANSPORTIN
RRUGOR TË MALLRAVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8378, datë 27.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministri i Punëve të Brendshme udhëzon:

Neni 1

Për qëllime të këtij udhëzimi do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

“Sezoni turistik veror” nënkupton periudhën nga data 15 maj deri më 30 shtator të vitit.

“Fundjava” nënkupton ditët e shtunë dhe të diel, fillon në orën 00:00 të ditës së shtunë dhe përfundon në orën 24:00 të ditës së diel;

“Datat e caktuara në sezonin turistik” nënkupton datat sipas tabelës 1 të udhëzimit për periudhën e sezonit turistik.

Neni 2

Kufizimet e qarkullimit vendosen në rrugët jashtë qendrave të banuara për:

- ditët e festave;
- ditë të tjera të veçanta, që u shtohen ditëve të festave;
- ditë të tjera, që mund të paraprijnë ose të pasojnë ditët e reguara në shkronjat “a” dhe “b”.

- ngjarje apo gara sportive, kur kryhet në rrugë; dhe
- çdo ngjarje tjetër e cila ndikon në rrjedhshmërinë e qarkullimit dhe në kushtet e sigurisë rrugore në segmentet të listuar në aneksin 1, gjatë ditëve dhe orëve, sipas këtij udhëzimi, përveç atyre që parashikohen në pikën 5 të nenit 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000.

Neni 3

Kufizime për mjetet e mallrave

1. Ndalohet qarkullimi në rrugët publike, të parashikuara në aneksin 2 të këtij udhëzimi, i mjeteve ose kombinimit të mjeteve:

a) për transportin e mallrave me peshë të përgjithshme të autorizuar mbi 7.500 kg, do të jetë i kufizuar dhe do të lejohet në oraret e përcaktuara më poshtë;

b) me ngarkesë të pandashme me gjatësi maksimale më të madhe se 12 m (transportet me mjete jashtë norme ose transportet në kushte jo normale).

c) rrugore apo bujqësore që kanë shpejtësi më të vogël se 40 km/orë;

d) bujqësore dhe teknologjike që kalojnë përmasat kufitare sipas nenit 61 të Kodit Rrugor;

dh) për kursantët e autoshkollave mësimore.


2. Zbatimi i kufizimit

2.1 Fundjava për sezonin turistik

Kufizimi i mjeteve të përcaktuara në pikën 2 do të bëhet për ditët e fundjavës të periudhës nga 15 maj – 30 shtator. Shiko figurën nr. 1.

Kufizimet për ditët e fundjavës fillojnë nga ora 09:00 deri në orën 14:00 të ditës së shtunë. Për ditën e diel, kufizimi fillon nga ora 12:00 deri në orën 24:00.

Figura nr. 1
Fundjava gjatë sezonit turistik



2.2 Ditët e festave

Ditët e festave zyrtare dhe datat e caktuara për sezonin turistik, shiko figurën nr. 2. Data e caktuar për sezonin turistik për të gjitha rrugët janë sipas tabelës nr. 1.

Për ditët e festave zyrtare, të parashikuara në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare”, të ndryshuar, si dhe datat e caktuara në tabelën nr. 1, oraret e kufizimit të qarkullimit janë nga ora 14:00 e ditës para festës ose ditës para datës së caktuar deri në orën 24:00 dhe nga ora 12 e ditës së festës ose datës së caktuar deri në orën 24:00 të po asaj dite.




Tabela 1

Muaji	Datat
Maj	16
Qershor	1 dhe 16
Korrik	1 dhe 16
Gusht	1 dhe 16
Gusht	1 dhe 16
Shtator	1, 16 dhe 30

Figura nr. 2

Ditët e festave zyrtare ose datat caktuara për sezonin turistik




■ Periudha e kufizuar

2.3 Përkimi i ditëve të fundjavës me datat e caktuara dhe/ose me ditët e festave

Në rast se ditët e fundjavës përkojnë me ditët e festave dhe/ose me datat e caktuara të sezonit turistik (shiko figurën nr. 3), kufizimi fillon në orën 14:00 të një dite më parë se dita e diel/festës/datës së caktuar dhe vazhdon deri në orën 02:00 të ditës së hënë/që vjen pas festës/datës së caktuar.

Figura nr. 3

Përkimi i ditëve të fundjavës, ditët e festës kombëtare dhe datat e caktuara sipas tabelës 1 për sezonin turistik




■ Periudha kufizuar

2.4 Kufizimet e qarkullimit për festat lokale

Për ditët e festave lokale (shiko figurën nr. 4), kufizimet fillojnë nga ora 00:00 e ditës së festës lokale dhe vazhdojnë deri në orën 02:00 të ditës që vijon pas ditës së festës lokale.

Figura nr. 4

Ditët e festave lokale




■ Periudha e kufizuar

2.5 Kufizimet e qarkullimit kur ka më shumë se një ditë feste kombëtare

Në rastin kur ka më shumë se një ditë feste kombëtare dhe kur këto ditë janë njëra pas tjetrës (shiko figurën nr. 5), p.sh. rasti i festave të 28 dhe 29 Nëntorit, kufizimet fillojnë nga ora 14:00 e ditës së pragfestës dhe vijojnë deri në orën 24:00 të po asaj dite. Në ditën e parë të festës kufizimet fillojnë në orën 12:00 dhe vijojnë deri në orën 24:00 të po asaj dite. Në ditën e dytë të festës, kufizimet fillojnë në orën 12:00 dhe vijojnë deri në orën 02:00 të ditës që vijon pas ditës së dytë të festës.

Figura nr. 5

Ditët e festës kombëtare që janë në vijim të njëra-tjetrës



3. Gjatë periudhës së ndalimit, mjetet e regjistruara në Shqipëri, për të cilat zbatohet ky udhëzim, lejohen të hyjnë në Shqipëri përmes pikave kufitare të shprehura në aneksin 1, dhe duhet të shkojnë në zyrën doganore më të afërt apo të parkojnë në terminale nëse sheshi i doganës nuk ka vend për parkim.



Neni 3

1. Përfshihen nga ndalimi i parashikuar në këtë udhëzim mjetet e mëposhtme:

- a) Automjetet e shoqërimit;
- b) Automjetet e Forcave të Armatosura;
- c) Automjete për mirëmbajtjen e rrugëve, instalimet elektrike dhe mjete të ngjashme dhe mjetet për shpërndarjen e postës dhe gazeta;
- ç) Mjetet që i përkasin radio dhe televizion;
- d) Cisternave që transportojnë ujë të pijshëm;
- dh) Mjetet që transportojnë materiale ose pajisje për përdorim në situata të jashtëzakonshme;
- e) Kamionë dhe tërheqës me gjysmë-remorkio që janë të destinuar për mirëmbajtjen e rrugëve;
- ë) Kamionë dhe që transportojnë ushqime që prishen, të tilla si mish i freskët, qumësht të papërpunuar dhe produkte të qumështit të freskët, peshk të freskët dhe prodhimeve të detit, fruta dhe perime që prishen;
- f) Kamionë që transportojnë shpendë dhe bagëti të gjallë.

2. Automjetet e tjera lejohen vetëm në rastet kur, për shkak të kohës dhe rrethanave, në veçanti, transporti është i justifikuar apo i domosdoshëm për arsye të sigurisë, ose për shkak se vonesat mund të sjellin dëme të konsiderueshme materiale.

Neni 4

Ky udhëzim zbatohet për pjesën e mbetur të sezonit turistik 2014.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

ANEKSI 1
PIKAT KUFITARE

Pikat e kalimit të kufirit, më poshtë PK, jepen si vijon:

- I. Pikat e kalimit të kufirit me Malin e Zi:
 1. Hani i Hotit;
 2. Muriqan;
- II. Pikat e kalimit të kufirit me Maqedoninë:
 1. Qafë-Thana;
 2. Bllata;

3. Gorricë.

III. Pikat e Kalimit të kufirit me Kosovën

1. Qafë-Morina;
2. Morina.

IV. Pikat e kalimit të kufirit me Greqinë;

1. Kapshticë;
2. Tre Urat;
3. Kakavijë;
4. Qafë-Botë.

ANEKSI 2

Segmentet rrugore për të cilët do të zbatohet ky udhëzim.

Segmenti rrugor PK e Muriqanit (pika kufitare me Malin e Zi) – Shkodër; PK Hani i Hotit – Shkodër; Shkodër (pika kufitare me Malin e Zi) – Plazhi i Zogajt, Shkodër – Plazhi i Shirokës; Shkodër – Velipojë.

Segmenti Shkodër – Lezhë; Lezhë – Shëngjin; Lezhë – Patok;

Durrës – Tiranë;

Durrës – Gjiri i Lalzit; Durrës – Currila;

Segmenti Durrës - Kavajë

Kavajë – Plazhi i Gjeneralit; Kavajë – Spille;

Kavajë – Kthesa e Divjakës – Lushnjë;

Lushnjë – Fier; Fier – Seman;

Fier – Plazhet e Poros dhe Zvërnecit - Vlorë;

Segmenti Vlorë – Palas – Dhërmi – Vuno – Himarë Qeparo – Borshit – Bunecit – Sarandë.

PK Qafë-Botë – Sarandë (pika kufitare me Greqinë).

Sarandë – Butrint.

Segmenti Qafë Thanë – Lin – Pogradec – Tushemisht (pika kufitare me Maqedoninë).

Segmenti Tepelenë – Gjirokastër – Kakavijë (pika kufitare me Greqinë).

PK Morinës (pika kufitare me Kosovën) – Kukës – Kryqëzimi i Milotit – Durrës.

PK Morinës (pika kufitare me Kosovën) – Kukës – Kryqëzimi i Milotit – Lezhë.

PK Morinit (pika kufitare me Kosovën) – B. Curri.

Segmentet për ditën e festës fetare lokale

Laç – Shën Ndou;

Durrës – Shën Vlash;

Berat – Mali Tomorit

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

**Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014**

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006

Çmimi 12 lekë